



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

KËSHILLI I BASHKISË MALLAKASTËR

Nr. 460 prot.

Ballsh, më 28.01 .2022

VENDIM

Nr 01 datë 27 / 01 / 2022

PER MIRATIMIN E KRITEREVE PER FAMILJET NE NEVOJE QE DO TRAJTOHEN ME NDIHME EKONOMIKE DERI NE 6 % TE FONDIT TE KUSHTEZUAR PER BLOK-NDIHMEN EKONOMIKE ,AI DHE PER ATO QE DO TRAJTOHEN ME FONDET E BUXHETIT VENDOR PER VITIN 2022.

Keshilli bashkiak ne mbledhjen e dates 27/01/2022,pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria Ekonomike dhe Ceshtjeve Sociale,si dhe mbeshtetje te Ligjin nr. 139/2015 " Per vetqeverisjen vendore ":Ligjit Nr 9936 date 26/06/2008"Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise"l ndryshuar ,Ligjin Nr 109/2017:Ligjit Nr 57/2019 " PER ASISTENCEN SOCIALE NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE",Neni 21"Roli i Keshillit Bashkiak"VKM Nr 597 date 04/09/2019,te Keshillit te Ministrave"Per percaktimin e procedurave te dokumentacionit dhe mases mujore e perfitimit te ndihmes ekonomike dhe perdorimit te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar per ndihmen ekonomike", Kapitulli IV"PERDORIMI I FONDIT SHITES MBI FONDIN E KUSHTEZUAR PER NDIHMEN EKONOMIKE",VKM.Nr 868,date 29/12/2021,DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NE VENDIMIN NR 597,DATE 04.09.2019,TE KESHILLIT TE MINISTRAVE"PER PERCAKTIMIN PROCEDURAVE,DOKUMENTACIONIT DHE MASES MUJORE TE PERFITIMIT TE NDIHMES EKONOMIKE DHE PERDORIMIT TE FONDIT SHITES MBI FONDIN E KUSHTEZUAR PER NDIHMEN EKONOMIKE",si dhe Udhezimet,e Ministrise se Shendetesise dhe Mireqenies Sociale per bllokndihmen ekonomike deri 6 %,me fondet e buxhetit qendror dhe vendor,propozuar nga Drejtoria Ekonomike dhe Ceshjeve Sociale:

VENDOSI:

Miratimin e kritereve per familjet ne nevoje,qe do trajtohen me ndihme ekonomike deri ne 6 %,te fondit te kushtezuar per bllok-ndihmen ekonomike,si dhe ato qe do trajtohen me fondet e buxhetit vendor , si me poshte vijon ;

Kriteret per perfituesit nga programi I bllok-ndihmes 6 % nga fondi I kushtezuar dhe me fondet e buxhetit vendor :

- ❖ Familjet te cilat kane aplikuar per ndihme ekonomike,brenda tre muajeve dhe nuk jane perzgjedhur fituese nga sistemi i pikezimit.
- ❖ Familjet te cilat perzgjidhen per tu trajtuar me kete fonde duhet te jene te verifikuara paraprakisht nga Administratori shoqeror.
- ❖ Familjet e perzgjedhura duhet te jene familje ne nevoje,pa te ardhura ose me te ardhura te pamjaftueshme.
- ❖ Familje me Kryefamiljare gra(vajza nena, te veja, te divorcuara),me te pakten nje femije: te mitur,ndjek arsimin baze ose te larte.
- ❖ Familje kur K/familjari ose antare te familjes,qe jane te paafte per pune ,por per shkak te Legjislacionit ne fuqi nuk perfitojne pagesa P.A.K.
- ❖ Femije jetim ne ose nen moshe,pleqe dhe individe te vetmuar,pa te ardhura ose te ardhura te pamjaftueshme.
- ❖ Familje qe kene femije ne moshe madhore,por qe kane probleme sociale(perdorues te lendeve narkotike,probleme me ligjin etj)te cilet kane veshtiresi punesimi.
- ❖ Prinder me shume femije.

Drejtoria Ekonomike dhe Ceshtjeve Sociale,do te propozoje cdo muaj numrin e familjeve per cdo Njesi ne baze te fondit te disponueshem.



KRYETARI I KESHILLIT

Mbarime ISUFAJ